



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Nr. 77**

**6 korrik**

**2012**

## P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Urdhër i MBUMK nr. 178, datë 4.6.2012	Për miratimin e rregullores “Mbi listat e kafshëve dhe produkteve, subjekt i kontrolleve në pikat e inspektimit kufitar” .....	3557
Urdhër i MASH nr. 219, datë 29.5.2012	Për hapjen e programeve të reja të studimit pranë institucionit privat “Shkolla e Lartë Ndërkombëtare e Tiranës” .....	3579
Urdhër i MASH nr. 220, datë 29.5.2012	Për hapjen e programeve të reja “Master profesional” dhe fillimin e veprimtarisë akademike për këto programe, pranë shkollës së lartë private “Universiteti Planetar i Tiranës”, Tiranë .....	3580
Urdhër i MASH nr. 230, datë 6.6.2012	Për hapjen e programit të ri të studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Logopedi” dhe fillimin e veprimtarisë akademike për këtë program pranë shkollës së lartë universitare private “Medikadent” .....	3580
Vendim i ERE nr. 67, datë 6.6.2012	Për licencimin e shoqërisë “Hydroborsh” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hecet “Fterra”, “Fterra 1” .....	3581
Vendim i ERE nr. 68, datë 6.6.2012	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “EVN Trading” sh.p.k. në aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike .....	3582
Vendim i ERE nr. 69, datë 6.6.2012	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Danske Commodities Albania” sh.p.k. në aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike .....	3583

Vendim i ERE  
nr. 70, datë 6.6.2012

Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “E.T.H.H.” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hecet “Kozel”, “Helmes 1” dhe “Helmes 2”....	3584
Vendim për heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Besnik Kakanozi.....	3585
Vendim për heqjen e zotësisë për të vepruar dhe dhënie kujdestarie të shtetasës Suela Gjondedaj .....	3585
Vendim për transferim kujdestarie për shtetasin Arben Allmeta .....	3585

**URDHËR**  
**Nr. 178, datë 4.6.2012**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “MBI LISTAT E KAFSHËVE DHE PRODUKTEVE,  
SUBJEKT I KONTROLLEVE NË PIKAT E INSPEKTIMIT KUFITAR”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, si dhe në zbatim të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin”, të ligjit nr. 10 465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, nenit 76 të ligjit nr. 9590, datë 27.7.2006 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Europian dhe shteteve të tyre anëtare” dhe pikës 5 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 463, datë 5.7.2006 “Për miratimin e planit kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit”, të ndryshuar,

**URDHËROJ:**

1. Miratimin e rregullore “Mbi listat e kafshëve dhe produkteve, subjekt i kontrolleve në pikat e inspektimit kufitar”, si dhe shtojcat I dhe II, bashkëlidhur kësaj rregulloreje.
2. Ngarkohet Drejtoria e Politikave të Sigurisë Ushqimore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Drejtoria e Shërbimit Veterinar dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit për zbatimin e këtij urdhri.  
Ky urdhër hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I BUJQËSISË, USHQIMIT  
DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT**  
**Genc Ruli**

**RREGULLORE**  
**MBI LISTAT E KAFSHËVE DHE PRODUKTEVE SUBJEKT I KONTROLLEVE NË PIKAT E  
INSPEKTIMIT KUFITAR**

**Neni 1**  
**Lënda**

Kjo rregullore përcakton listat dhe rregullat në lidhje me kafshët dhe produktet që do t'i nënshtrohen kontrollit veterinar në pikat e inspektimit kufitar, në përputhje me rregulloren nr. 4, datë 3.7.2000 “Për organizimin e kontrolleve veterinare të kafshëve të gjalla që hyjnë në Republikën e Shqipërisë nga vende me të cilat ka marrëdhënie tregtare” dhe rregulloren nr. 7, datë 3.7.2000 “Për parimet e organizimit të kontrolleve veterinare të produkteve që hyjnë në Republikën e Shqipërisë nga vendet e treta”.

**Neni 2**  
**Përkufizimet**

Për qëllime të kësaj rregulloreje, të zbatohen termat e mëposhtëm:  
a) “Produkt i përbërë” quhet një ushqim i destinuar për konsum njerëzor, që përmban produkte të përpunuara me origjinë shtazore dhe produkte me origjinë bimore, dhe i përfshin ato në



produktin përfundimtar, kur përpunimi i produkteve primare është një pjesë integrale e prodhimit të produktit përfundimtar.

b) “Produkte mishi” quhen produktet e përcaktuara sipas pikës 2, germa “o” të udhëzimit nr. 23, datë 25.11.2010 “Për kërkesat specifike të higjienës për mishin dhe produktet e mishit, duke përfshirë produktet e mishit, mishin e grirë dhe mishin e ndarë në mënyrë mekanike”.

c) “Produkte të përpunuara” quhen produktet e përpunuara të përcaktuara sipas pikës 2, gjerat “d”, “j”, “k”, “i”, “h”, “m” të udhëzimit nr. 21, datë 25.11.2010 “Mbi kërkesat specifike të higjienës dhe kontrollet zyrtare për produktet me origjinë shtazore”, si dhe sipas pikës 2, germa “o” të udhëzimit nr. 25, datë 25.11.2010 “Mbi kushtet higjienike dhe kontrollet për molusqet e gjalla bivalvove, peshkun dhe produktet e peshkimit”.

d) “Produkte qumështi” quhen produktet e përcaktuara sipas pikës 3, germa “c” të udhëzimit nr. 5, datë 25.3.2011 “Mbi kërkesat specifike të higjienës për stabilimentet e prodhimit, grumbullimit dhe përpunimit të qumështit, dhe produkteve me bazë qumështi”.

### Neni 3

#### **Kontrollet veterinare të kafshëve dhe produkteve**

1. Kafshët dhe produktet e listuara në shtojcën I të kësaj rregulloreje u nënshtrohen kontrolleve veterinare në pikat e inspektimit kufitar në përputhje me rregulloren nr. 4, datë 3.7.2000 “Për organizimin e kontrolleve veterinare të kafshëve të gjalla, që hyjnë në Republikën e Shqipërisë nga vende me të cilat ka marrëdhënie tregtare” dhe rregulloren nr. 7, datë 3.7.2000 “Për parimet e organizimit të kontrolleve veterinare të produkteve, që hyjnë në Republikën e Shqipërisë nga vendet e treta”.

2. Kjo rregullore zbatohet pa rënë ndesh me kontrollet në produktet e përbëra, të nevojshme për të siguruar përputhjen me kërkesat e shëndetit publik.

3. Përzgjedhja fillestare e produkteve, që u nënshtrohen kontrollit veterinar, bëhet në bazë të nomenklaturës së kombinuar në kolonën 1 të shtojcës I, të cilat janë të specifikuar ose cituara në kolonën 3 të shtojcës I.

### Neni 4

#### **Produktet e përbëra, subjekt i kontrolleve veterinare**

Produktet e përbëra, subjekt i kontrolleve veterinare janë si më poshtë:

a) produktet e përbëra, të cilat përmbajnë produkte mishi të përpunuara;

b) produktet e përbëra në të cilat gjysma ose më shumë se gjysma e përmbajtjes së tyre, përbëhet nga produkte të përpunuara me origjinë shtazore, përveç produkteve të përpunuara të mishit;

c) produktet e përbëra, të cilat nuk përmbajnë produkte të përpunuara të mishit dhe në të cilat më pak se gjysma e përbërjes së tyre përbëhet nga produkte të përpunuara të qumështit, ku produkti final nuk plotëson kërkesat e nenit 6.

### Neni 5

#### **Certifikata që shoqëron produktet e përbëra, subjekt të kontrolleve veterinare**

1. Produktet e përbëra, të cilat përmbajnë produkte mishi të përpunuara, hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë të shoqëruara nga certifikata përkatëse për produktet e mishit, pavarësisht përmbajtjes të çdo lloji produkti tjetër shtazor.

2. Produktet e përbëra të përmendura në nenin 4 (b) dhe 4 (c), të cilat përmbajnë produkte të përpunuara qumështi, hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, të shoqëruara nga certifikata përkatëse.

3. Produktet e përbëra, të cilat përmbajnë vetëm produkte të përpunuara peshkimi apo produkte vezësh me origjinë shtazore, hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, të shoqëruara nga certifikata përkatëse e përcaktuar në legjislacionin në fuqi apo një dokument tregtar kur certifikata nuk është e nevojshme.

#### Neni 6

#### **Përfshirje për disa produkte të caktuara të përbëra dhe produkte ushqimore**

1. Me përjashtim të nenit 3, produktet e përbëra ose produktet ushqimore të destinuara për konsum njerëzor, të cilat nuk përmbajnë ndonjë produkt të mishit dhe të cilat nuk janë subjekt i kontrolleve veterinarë janë si më poshtë:

a) produktet e përbëra, të cilat në më pak se gjysmën e përmbajtjes së tyre përbëhen nga produkte të përpunuara, të siguruar nga produkte, të tilla si:

i) produkte të qëndrueshme në temperaturën e ambientit ose të cilat kanë kaluar gjatë përpunimit të tyre një gatim të plotë ose një proces trajtimi me ngrohje në të gjithë përmbajtjen e tyre, në mënyrë që çdo lëndë e parë të jetë denaturuar;

ii) produkte të identifikuar qartë si të destinuara për konsum njerëzor;

iii) produkte të paketuara në mënyrë të sigurt ose të vulosura në mbajtëse (pajisje ose enë) të pastër;

iv) produkte të shoqëruara nga një dokument tregtar dhe të etiketuara në gjuhën shqipe për t'u ofruar te konsumatori i fundit, në mënyrë që dokumenti dhe etiketimi së bashku të japin informacion për natyrën, sasinë dhe numrin e paketimeve të produkteve të përbëra, vendin e origjinës, prodhuesin, si dhe përbërësit;

b) produkte të përbëra ose ushqimet e listuara në shtojcën II.

2. Produktet e qumështit të përfshira në çdo produkt të përbërë, të prodhuar dhe të trajtuar në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### SHTOJCA I

#### **LISTA E KAFSHËVE DHE PRODUKTEVE SUBJEKT I KONTROLLEVE VETERINARE, SIPAS NENIT 3**

Kjo listë përcakton kafshët dhe produktet në përputhje me nomenklaturën e mallrave në fuqi në lidhje me ngarkesat, që janë subjekt i kontrolleve veterinarë në pikën e inspektimit kufitar.

Shënime

1. Kolona 1:

Kur përdoret një kod katërshifror, përveç nëse specifikohet ndryshe të gjitha produktet me prefiks apo që mbulohen nga katër shifra, i kalojnë për kontroll veterinar, inspektorit veterinar në pikën e inspektimit kufitar.

Kur kërkohen për ekzaminim vetëm produkte të caktuara nën çdo kod dhe pa nënndarje specifike nën këtë kod në nomenklaturën e mallrave, kodi shënohet Ex (për shembull, Ex 3002: kontroll veterinar i kërkuar vetëm për materiale që rrjedhin nga kafshët dhe jo për tërë kreun).

2. Kolona 2:

Përshkrimi i mallrave është siç është përcaktuar në shënimet e shpjegimeve të sistemit të harmonizuar të organizatës botërore të doganave, ose mund të gjendet në shënimet shpjeguese të Nomenklaturës së Kombinarur që njihen si kodet e Nomenklaturës së Kombinarur (NK).



### 3. Kolona 3:

Kjo kolonë jep detaje të produkteve që mbulohen.

Në disa raste ka kafshë të gjalla të caktuara (të tilla si: reptilët, amfibët, insektet, krimbat apo jovvertebrorë të tjerë) ose produkte shtazore të dërguara te veterineri zyrtar, për të cilat nuk ka kushte të harmonizuara në lidhje me shëndetin e kafshëve për importet, prandaj nuk ka certifikatë të harmonizuar importi.

Kushtet e importit, për të gjitha kafshët e gjalla jo të specifikuara diku tjetër, përfshihen në këtë rregullore. Veterinerët zyrtarë ekzaminojnë ngarkesat dhe lëshojnë dokumentin veterinar të import transitit (DVIT) për të treguar se i është nënshtruar kontrollit dhe se kafshët janë të lira për të qarkulluar në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Në disa raste të nënprodukteve me origjinë shtazore, që nuk janë të destinuara për konsum njerëzor, kontrollet veterinare kryhen për produktet që janë përpunuar, por që janë akoma në thelb lëndë e parë e papërpunuar masive, e cila do të përpunohet më tej para se të shkojë te konsumatori përfundimtar.

Në këto raste, veterineri zyrtar në pikat e inspektimit kufitar të specifikojë nëse një produkt i veçantë që rrjedh dhe është përpunuar në një mënyrë që nuk është subjekt i kontrolleve veterinare, të parashikuara në legjislacionin në fuqi.

### TABELA

Pavarësisht nga rregullat për interpretimin e Nomenklaturës së Kombinuar, formulimi për përshkrimin e produkteve në kolonën 2 të konsiderohet që të ketë jo më shumë se një vlerë treguese, fushëveprimi përcaktohet brenda kontekstit të shtojcës nga fusha e kodeve NK.

Kodi NK	Përshkrimi	Specifikime dhe shpjegime
	Kafshë të gjalla	
0101	Kuaj të gjallë, gomarë, mushka dhe hibridë të saj	Të gjitha
0102	Gjedhë të gjallë	Të gjitha
0103	Derra të gjallë	Të gjitha
0104 10	Dele të gjalla	Të gjitha
0104 20	Dhi të gjalla	Të gjitha
0105	Shpendë të gjalla, shpendë të llojit Gallus Domesticus, rosa, pata, gjela deti, pula afrikane	Të gjitha
0106	Kafshë të tjera të gjalla	Të gjitha

Krerët përfshijnë kafshët shtëpiake ose të egra të mëposhtme:

A) Gjitarët;

1) Primatët;

2) Balena: delfinë dhe derra deti (gjitarë të rendit Cetacea); lopët e detit (gjitarë të rendit Sirenia);

3) Të tjerë (si: drerë, mace, qen, luanë, tigër, ari, elefant, gamile, zebër, lepur i egër, kaproll, antilopë, dhi e egër, dhelpër, bizon dhe kafshë të tjera për ferma gëzofi);

B) Reptilët (përfshirë gjarpërinjtë dhe breshkat);

C) Shpendët;

1) Shpendët grabitqarë;

2) Familja e papagallëve (duke përfshirë papagall dhe papagall trupvogël);

3) Të tjera (të tilla si: thëllëza, fazanë, shkurte, shapkë e egër, pëllumba, rosa të egra, pata të egra, mëllenjë, sorrë, luaneshë, trishtil, xhixhimës, kolibër, pallonj, mjellma dhe shpendë të tjerë që nuk janë të specifikuar në kreun 01.05);

D) Të tjera, si bletët (nëse udhëtojnë ose jo në kuti, kafaze apo koshere), insektet e tjera, bretkosa.

Kreu 0106 përjashton kafshë të cilat janë pjesë e cirkut, kafshët e egra ose kafshë të tjera udhëtare të ngjashme (kreu 95.08).

Kodi NK	Përshkrimi	Specifikime dhe shpjegime
0106 11	Primatët	Të gjitha
0106 12	Balenat, delfinët dhe derrat e detit (gjitarë të llojit Cetacea); lopët e detit (gjitarë të llojit Sirenia)	Të gjitha
0106 19	Të tjera	Lepuj shtëpiakë, gjitarë të tjerë nga ato të 0101, 0102, 0103, 0104, 0106 11, 0106 12 Përfshirë qentë dhe macet
0106 20	Zvarranikë (përfshirë gjarpërinj dhe breshka deti)	Të gjitha
0106 31	Shpendë grabitqarë	Të gjitha
0106 32	Psittaciformes (përfshirë papagall, papagall trupvogël)	Të gjitha
0106 39	Të tjerë	Përfshirë: zogj, përveç atyre në kreun 0106 31, 0106 32, përfshirë pëllumbat
0106 90 00	Të tjerë	Të gjitha kafshët e gjalla që s'janë përfshirë tjetërkund, përveç gjitarëve, zogjve, zvarranikëve. Bretkosat e gjalla për vivarium për t'u mbajtur të gjalla ose për therje për konsum njerëzor, mbulohen nga ky kre
	<b>Kapitulli 2: Mishi dhe të brendshmet e ngrënshme të mishit</b>	
	Ky kapitull nuk përfshin: a) produkte të një lloji të përshkruar në krerët 0201-0208 ose 0210 të papërshtatshëm ose të papërdorshëm për konsum njerëzor; b) zorrë, fshikëza ose stomakë të kafshëve (kreu 0504) apo gjak kafshësh (kreu 0511 apo 3002); c) yndyrna kafshësh përveç atyre të produkteve të kreut 0209 (kapitulli 15)	
0201	Mishi i gjedhëve i freskët ose i ftohtë	Të gjitha
0202	Mishi i gjedhëve i ngrirë	Të gjitha
0203	Mishi i derrave i freskët, i ftohtë ose i ngrirë	Të gjitha
0204	Mishi i deleve ose dhive, i freskët, i ftohtë ose i ngrirë	Të gjitha
0205 00	Mishi i kuajve, gomarëve, mushkave ose hibridit të saj i freskët, i ftohtë ose i ngrirë	Të gjitha
0206	Të brendshmet e ngrënshme të gjedhëve, derrave, deleve, dhive, kuajve, gomarëve, mushkave apo hibridit të gomaricës, të freskëta, të ftohta ose të ngrira	Të gjitha
0207	Mishi dhe të brendshmet e ngrënshme të shpendëve të kreut 0105 të freskëta, të ftohta apo të ngrira	Të gjitha



0208	Mish tjetër dhe të brendshmet e ngrënshme të mishit, të freskëta, të ftohta apo të ngrira	Përfshihet: lëndën e parë jo për konsum njerëzor Përfshin kockat dhe materiale të tjera për prodhimin e xhelatinës ose kolagenit për konsum njerëzor
0208 10	Të lepujve të butë ose të egër	Të gjitha
0208 20 (00)	Këmbë bretkose	Të gjitha
0208 30	Të primatëve	Të gjitha
0208 40	Balenat, delfinët dhe derrat e detit (gjitarë të llojit cetace); lopët e detit (gjitarë të llojit Sirenia)	Të gjitha
0208 50 (00)	Të zvarranikëve (duke përfshirë gjarpërinjtë dhe breshkat)	Të gjitha
0208 90	Të tjera: pëllumbave shtëpiakë, kafshëve të egra për gjueti, përveç lepujve të butë apo të egër	Përfshin mish shkurte, mish foke, dre ose çdo gjitar tjetër
0209 00	Dhjamë derri, mish pa dhjamë dhe dhjamë shpendësh jo i nxjerrë me anë të shkrirjes apo jo i nxjerr ndryshe, i freskët, i ftohtë, i ngrirë, i kriposur, në ujë me kripë, i tharë apo i tymosur	Përfshin dhjamërat dhe dhjamin e përpunuar
0210	Mishi dhe të brendshmet e ngrënshme të kriposura, në ujë me kripë, të thara apo të tymosura; pudër e ngrënshme e mishit dhe të brendshmet	Të gjitha: Përfshin mish, produkte mishi, kocka për konsum njerëzor dhe produkte të tjera me origjinë shtazore.  Proteinat e përpunuara shtazore që përfshijnë dhjamë për konsum njerëzor që mbulohen nga ky kapitull. Përfshirë veshë të tharë derri për konsum njerëzor.  Sallamrat që përfshihen në kreun 1601
	<b>Kapitulli 3: Peshk dhe krustacë, molusqet dhe jovertebrorët e tjerë ujorë</b>	

Ky kapitull nuk mbulon:

- a) gjitarë të kreut 0106;
- b) mish i gjitarëve të kreut 0106 (kreu 0208 ose 0210);
- c) peshk (duke përfshirë mëlçitë dhe vezët e tyre) ose krustacë, molusqe ose jovertebrorë të tjerë ujorë të ngordhur të papërshtatshëm ose të papërshtatshme për konsum njerëzor për shkak të specit (llojit) apo gjendjes së tyre (kapitulli 5); miellra ose ushqime të peletuara të peshkut apo të krustacëve, molusqeve ose jovertebrorë të tjerë ujorë të papërshtatshëm për konsum njerëzor (kreu 2301); ose
- d) havjar ose zëvendësues havjari i përgatitur prej vezëve të peshkut (kreu 1604).



		Ky kapitull përfshin: peshkun e gjallë për kultivim dhe riprodhim, peshqit e gjallë dekorativë, peshqit ose krustacët e gjallë që transportohen të gjallë, por të importuara për konsum njerëzor
		Të gjitha produktet në këtë seksion janë subjekt i kontrolleve veterinarë
0301	Peshk i gjallë	Të gjitha: përfshirë trofta, ngjala, krap ose çdo specie tjetër, ose çdo peshk i importuar për qëllime rritje ose riprodhimi  Peshk i gjallë i importuar për konsum njerëzor të menjëhershëm trajtohet për kontrolle veterinarë si të ishin produkte.  Përfshirë dhe peshqit dekorues nën kreun 0301 10
0302	Peshk i freskët apo i ftohtë, përjashto filetot e peshkut dhe mish tjetër prej peshku të kreut 0304	Të gjitha
030270	Mëlçitë dhe vezët	
0303	Peshk i ngrirë, përjashto filetot e peshkut dhe mish tjetër prej peshku të kreut 0304	Të gjitha: Përfshirë: salmonin e Paqësorit duke përjashtuar mëlçitë dhe vezët, salmonin e kuq; të tjera salmonide, duke përjashtuar mëlçitë dhe vezët. Troftat; salmonin e Atlantikut dhe të gjithë peshqit e tjerë
0304	Fileto dhe mish tjetër prej peshku (nëse është apo jo i grirë), i freskët, i ftohtë apo i ngrirë	
0305	Peshk i tharë, i kripur apo në ujë me kripë; peshk i tymosur, nëse është gatuar ose jo më parë ose gjatë procesit të tymosjes; miell, kokrriza dhe pele të peshkut, të përshtatshme për konsum njerëzor	Të gjitha: përfshirë të gjitha produktet e tjera të peshkimit, si: miellra, pelet për konsum njerëzor të bërë nga peshku, krustacët ose jovertebrorët e tjerë ujorë
0306	Krustacët, nëse janë apo jo në guaskë, të gjalla, të freskëta, të ftohta, të ngrira, të thara, të kripura apo në ujë me kripë; Krustacët, në guaskë, të gatuar në avull ose të ziera në ujë, të ftohura ose jo; Të ngrira, të thara, të kripura apo në ujë me kripë; miellrat, pelet e krustacëve të përshtatshme për konsum njerëzor	Të gjitha: krustacë të gjallë të importuara për konsum të menjëhershëm njerëzor, të konsiderohen dhe trajtohen për qëllime kontrolli veterinar si të ishin produkte
0307	Molusqet nëse janë apo jo në guaskë, të gjalla, të freskëta, të ftohta, të ngrira, të thara ose të kripura në ujë me kripë;  Kafshët e tjera jovertebrore ujore veç krustacëve dhe të molusqeve të gjalla, të freskëta, të ftohta, të ngrira;	Të gjitha: përfshirë Bonamia Ostreae dhe Martelia Refringes, gjithashtu molusqet dhe kafshët jovertebrore ujore të gatuar dhe më pas të ftohura ose të ngrira



	të thara ose të kripura në ujë me kripë; miellrat, pelet e kafshëve ujore jovvertebrore, përveç krustacëve të përshtatshme për konsum njerëzor.	Molusqe të gjalla të importuara për konsum të menjëhershëm njerëzor konsiderohen dhe trajtohen për qëllime të kontrolleve veterinarë si të ishin produkte  Përfshin mishin e specieve të kërmijve
0307 60 00	Kërmij ndryshe nga kërmijtë e detit	Përfshin gastropode tokësore të llojit <i>Helix pomatia</i> Linne, <i>Helix aspera</i> Muller; <i>Helix lucorum</i> dhe lloje të familjes Achatinidae  Përfshin kërmijtë e gjallë për konsum të menjëhershëm njerëzor dhe gjithashtu dhe mishin e kërmijve për konsum njerëzor  Përfshin kërmijtë e paratuar ose parapërpunuar
0307 91 00	Kafshët jovvertebrore ujore të gjalla, përveç krustacëve, molusqeve të gjalla, të freskëta ose të ftohta	Të gjitha
0307 99 90	Të tjera: Ky kod përfshin miellrat, pelet e kafshëve jovvertebrore ujore të tjera veç krustacëve, të përshtatshme për konsum njerëzor	Të gjitha: përfshirë ushqimet nga peshku për konsum njerëzor
	<b>Kapitulli 4: Produktet e qumështit, vezët e shpendëve, mjalti natyral, produktet e përshtatshme me origjinë shtazore, të paspecifikuara ose të përfshira diku tjetër</b>	

1. Termi “qumësht” do të thotë krem qumështi i plotë ose qumësht pjesërisht ose plotësisht i skremuar.

2. Për qëllime të kreut 0405:

a) termi “gjalpë” nënkupton gjalpin natyral, hirrë gjalpi ose gjalpin e rikombinuar (i freskët, i kripur apo prishur duke përfshirë gjalpin e konservuar), që rrjedh vetëm nga qumështi, me një përmbajtje yndyre qumështi prej 80% ose më shumë, por jo më shumë se 95% të peshës, një maksimum të trupave të ngurtë-joyndyrë prej 2% të peshës dhe një përmbajtje maksimale të ujit prej 16% të peshës. Gjalpi nuk përmban shtresa që ndihmojnë emulsionin, por mund të përmbajë klorur natriumi, ngjyrues ushqimor, kripëra të neutralizuara dhe kultura të bakteve të padëmshme të prodhimit të acidit laktik;

b) termi “ajka e qumështit” do të thotë një emulsion të shpërndarë të tipit ujë në yndyrë, që përmban si yndyrë qumështi të vetmen yndyrë në produkt, me një përmbajtje yndyre qumështi prej 39% ose më shumë, por më pak se 80% të peshës.

3. Produktet e përfuara nga përqendrimi i hirrës dhe me shtimin e qumështit ose yndyrës së qumështit do të klasifikohen si djathë në kreun 0406, me kusht që ato kanë tri karakteristikat e mëposhtme:

a) një përmbajtje yndyre qumështi, të peshës së lëndës së thatë, prej 5 % ose më shumë;

b) një përmbajtje të lëndës së thatë, prej të paktën 70 %, por jo më tepër se 85 % ndaj peshës; dhe

c) janë të mykur ose të aftë për t'u mykur.

4. Ky kapitull nuk përfshin:

a) produkte të përfituara nga hirra, që përmbajnë ndaj peshës më shumë se 95 % laktozë anhidër e llogaritur mbi peshën e lëndës së thatë (kreu 1702); ose

b) albuminat (përfshirë koncentratet e dy apo më shumë proteinave të hirrës, që përmbajnë ndaj peshës më shumë se 80% të proteinave të hirrës, e llogaritur mbi peshën e thatë) (kreu 3502) ose globulinat (kreu 3504).

Kodi NK	Përshkrimi	Specifikime dhe shpjegime
0401	Qumësht dhe krem, jo i koncentruar, që nuk përmban sheqer shtesë apo ndonjë lëndë tjetër ëmbëlsuese	Të gjitha: qumështi përfshin qumështin si lëndë e parë, të pasterizuar ose termizuar  Përfshirë fraksionet e qumështit  Qumështi për ushqim kafshësh përfshihet nën kreun 2309
0402	Qumësht dhe krem, i koncentruar ose që përmban sheqer shtesë apo lëndë të tjera ëmbëlsuese	Të gjitha
0403	Dhallë, qumësht i prerë dhe krem, kos, kefir dhe qumësht tjetër i fermentuar ose i acidifikuar dhe krem, nëse janë apo jo të koncentruara ose që përmbajnë sheqer shtesë apo lëndë të tjera ëmbëlsuese ose lëndë aromatizuese ose që përmbajnë fruta, arra ose kakao shtesë	Të gjitha:  Përfshirë kremin, gjalpin dhe qumështin me aromë, të mpiksur, të ngrirë dhe të fermentuar dhe qumështin e koncentruar për konsum njerëzor  Akullorja është përfshirë nën kreun 2105
0404	Hirrë, nëse është apo jo e koncentruar ose që përmban sheqer shtesë apo lëndë të tjera ëmbëlsuese; produkte që përbëhen nga përbërës të qumështit natyral, nëse përmbajnë sheqer shtesë apo lëndë të tjera ëmbëlsuese, të papërfshira apo të paspecifikuara diku tjetër	Të gjitha
0405	Gjalpë, yndyrna dhe vajra të tjera të rrjedhura nga qumështi: ajka e qumështit	Të gjitha: përfshirë ajkën e qumështit
0406	Djathë dhe gjizë	Të gjitha
0407 00	Vezët e shpendëve, në guaskë, të freskëta, të ruajtura ose të gatuar	Të gjitha: përfshirë vezët për çelje dhe vezët e pastra nga patogjenët e specifikuar (PPS) dhe vezët për konsum njerëzor  Përfshirë vezët "100-vjeçare"  Albumina e vezëve jo e përshtatshme për konsum njerëzor përfshihet nën kreun 3502
0408	Vezët e shpendëve, jo në guaskë dhe të verdhat e vezëve, të freskëta, të thara, të gatuar në avull ose të ziera në ujë, të formuara, të ngrira apo të ruajtura ndryshe, nëse përmbajnë apo jo sheqer shtesë ose lëndë të tjera ëmbëlsuese shtesë	Të gjitha: ky kre përfshin produktet e vezëve nëse janë apo jo të trajtuara



Ky kre mbulon vezët e plota pa guaskë dhe të verdhat e vezëve të të gjitha llojeve të shpendëve. Produktet e këtij kreu mund të jenë të freskëta, të thata, të gatuar në avull ose të ziera në ujë, të formuara (p.sh. “vezë të gjata” cilindrike), të ngrira apo të ruajtura ndryshe. Të gjitha këto përfshihen në kreun nëse përmbajnë ose jo sheqer apo lëndë të tjera ëmbëlsuese dhe nëse janë për përdorim si ushqim ose për qëllime industriale (p.sh. për regjije).

Ky kre nuk përfshin:

- vaj i të verdhës së vezës (kreu 15.06);
- përgatitje veze që përmbajnë erëza, aroma ose aditivë të tjerë (kreu 21.06);
- lecitinë (kreu 29.23);
- të bardha veze të ndara (albumin veze) (kreu 35.02).

Kodi NK	Përshkrimi	Kualifikime dhe shpjegime
0409 00 00	Mjaltë natyral	Të gjitha

Ky kre mbulon mjaltin e prodhuar nga bletët (*Apis Mellifera*) ose nga insektet e tjera, të centrifuguara ose të kaluara në krehër ose në copëza që përmbajnë krehër, me kusht që nuk i është shtuar as sheqer dhe as një substancë tjetër. Mjalti i tillë mund të përcaktohet nga burimi i luleve, origjina ose ngjyra.

Ky kre përjashton mjaltin artificial dhe përzierjet e mjaltit natyral me atë artificial (kreu 17.02).

Kodi NK	Përshkrimi	Kualifikime dhe shpjegime
04010 00 00	Produkte të ngrënshme me origjinë shtazore, të papërfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër	Të gjitha:  Ky kre përfshin xhelatinën mbretërore (qumësht blete) dhe propolisin, si dhe kockat ose ndonjë material tjetër shtazor për konsum njerëzor  Insektet ose vezët e insekteve për konsum njerëzor të përfshira nën këtë kre

Ky kre 0410 00 00 mbulon produktet me origjinë shtazore të përshtatshme për konsum njerëzor, jo të specifikuar ose përfshira diku tjetër në Nomenklaturën e Kombinuar.

Kjo përfshin:

- vezët e breshkës;
- fole salanganes (foletë e zogjve).

Kreu 0410 00 00 përjashton gjakun e kafshëve, i ngrënshëm apo jo, i lëngshëm ose i thatë (kreu 05.11 apo 30.02).

<b>Kapitulli 5: Produktet me origjinë shtazore, të paspecifikuara ose të përfshira diku tjetër</b>
--

Ky kapitull nuk përfshin:

a) produkte të ngrënshme (përveç zorrëve, fshikëzave dhe stomakëve të kafshëve, të plota ose pjesë të tyre, si dhe gjak të kafshëve, i lëngët ose i thatë);

b) lëkurat me qime ose lëkurat (përfshirë lëkurat me gëzofin), përveç specifikimeve të kreut 0505, copat dhe mbeturinave të ngjashme të lëkurave dhe gëzofëve në gjendje të papërpunuar të kreut 0511 (kapitulli 41 ose 43);

c) materialet tekstile të kafshëve, përveç mbeturinave të flokëve të kalit dhe qimeve të kalit (seksioni XI); ose

d) nyjat e përgatitura ose tufa për fshesë ose bërjen e furçave (kreu 9603).

2. Gjatë gjithë nomenklaturës, brirët e elefantit, hipopotamit, lopës së detit, balenave trupvogla, dhëmbët e derrit të egër, brirët e rinoqerontëve dhe dhëmbët e të gjitha kafshëve që konsiderohen si “fildish”.

3. Gjatë gjithë nomenklaturës, termi “flokë kali” kupton flokët e krifës ose të bishtit të kuajve (njëthundrakëve) apo gjedhëve.

Kodi NK	Përshkrimi	Kualifikime dhe shpjegime
0502 10 00	Derrat, qimet dhe kreshtat e derrave të butë dhe derrave të egër, si dhe mbetjet e tyre	Kreshtat e papërpunuara të derrit nënkuptojnë kreshtat e derrit, që nuk i janë nënshtruar larjes në fabrikë, nuk janë regjur ose nuk janë trajtuar me ndonjë metodë tjetër, për të garantuar që s'ka mbetje patogjene
0503 00 00	Qimet e kalit dhe mbeturinat e qimeve të kalit	Duhet të kërkohen prova të statusit, specieve dhe trajtimit të marrë

Kreu 0503 përjashton flokët që kanë pësuar një proces tjerre, ose është një në fund. Ky kod nuk përfshin vetëm qimet e kalit të papunuar, por edhe qimet e kalit që janë larë, lyer, zbardhur përdredhur apo të përgatitura ndryshe.

Kodi NK	Përshkrimi	Kualifikime dhe shpjegime
0504 00 00	Të brendshmet, fshikëzat dhe stomakët e kafshëve (përveç atyre të peshkut), të plota dhe pjesë prej tyre, të freskëta, të ftohta, të ngrira, të kripura, në ujë me kripë, të thara apo të tymosura	Të gjitha: përfshirë stomakë, fshikëza dhe zorrë të pastruara, të kripura, të thara ose të trajtuara me ngrohje të gjedhëve, derrave, kuajve, dhive ose me origjinë nga shpendët
0505	Lëkurët dhe pjesë të tjera të shpendëve, me puplat dhe pushin e tyre, puplat dhe pjesët e puplave (nëse janë apo jo të zbukuruara në anë) dhe pushi, jo më tej i përpunuar përveçse i pastruar, i dezinfektuar ose trajtuar ndryshe për ruajtje; pluhura dhe mbetje të puplave apo të pjesëve prej puplave	Të gjitha: duke përjashtuar pupla të trajtuara dekorative, pupla të trajtuara të bartura nga udhëtarë për përdorim privat ose ngarkesat e puplave të trajtuara për qëllime private individuale dhe jo për qëllime industriale

Kreu 0505 mbulon të patrajtuarat, si dhe ato të trajtuara si më poshtë: vetëm të pastruara, të dezinfektuara ose të trajtuara për qëllime ruajtje, por jo të ndryshuara.

		Puplat që përdoren për mbushje dhe pupla të tjera në formë të lëndës së parë
0506	Kockat dhe palca e brirëve të përpunuara, të çyndyrosura, të përgatitura (jo të prera në forma), të trajtuara me acid ose të dexhelatinosura; pluhura dhe mbetje të këtyre produkteve	Përfshin kockat për prodhim xhelatine, kolagjeni nëse vjen nga karkasat që janë therur për konsum njerëzor dhe pluhuri i kockave për konsum njerëzor



0507	Fildish, guaskat e breshkave, lapat e balenave dhe mustaqet e lapave të balenave, brirët, thundrat, thonjtë, kthetrat dhe sqepat, të papërpunuara ose të përgatitura, por jo të prera në forma; pluhuri dhe mbetjet e këtyre produkteve	Përfshin kafshët e egra për gjah nga shpendët dhe thundrakëve që kanë kocka, brirë, thundra, kthetra, dhëmbë, lëkurë dhe gëzof nga vendet e treta
Ex 0510 00 00	Qelibar i hirtë, kastori, zibet dhe myshku; kantharides; vreri nëse është ose jo i tharë  Gjëndrat dhe produkte të tjera me origjinë shtazore të përdorur në përgatitjen e produkteve farmaceutike, të freskëta, të ftohta, të ngrira apo të ruajtura në mënyra të tjera	Përfshin nënproduktet shtazore për përpunimin e ushqimit për kafshë, duke përfshirë ushqimin për kafshët e shoqërimit dhe produkte farmaceutike dhe teknike  Gjëndrat, produktet e tjera shtazore dhe tëmthi mbulohen nga ky kod  Gjëndrat e thara dhe produktet mbulohen nga kreu 3501
0511	Produktet me origjinë shtazore të papërfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër; kafshët e ngordhura, të kapitullit 1 ose 3, të papërshtatshme për konsum njerëzor	Përfshin material gjenetik (spermë dhe embrione me origjinë shtazore të gjedhëve, kuajve, dhive, dhenve dhe derrave)  Përfshin edhe nënprodukte shtazore të kategorive 1 dhe 2
0511 10 00	Sperma e demave	
0511 91	Produkte të peshkut ose të krustacëve, molusqeve dhe ose kafshë të tjera jovertebrore ujore; kafshë të ngordhura të kapitullit 3	Të gjitha: përfshin vezë peshku për çelje; dhe kafshë të ngordhura  Përfshin nënprodukte shtazore për përpunimin e ushqimit të kafshëve të shoqërimit dhe produktet farmaceutike e teknike
0511 99 (10)	Fijet lidhëse të muskujve me kockën; mbetje të prerjeve dhe mbetje të ngjashme të lëkurëve të papërpunuara në gjendje bruto	Të gjitha
0511 99 90	Të tjera	Të gjitha: embrionet, vezët, sperma dhe materiali gjenetik nuk mbulohen në 0511 10 dhe llojet e tjera përveç gjedhit janë nën këtë kre  Përfshin nënproduktet shtazore për prodhimin e ushqimit për kafshë ose produkte të tjera teknologjike  Përfshin produktet e bletëve për përdorim në bletari  Përfshin kafshë të ngordhura nga kapitulli 1 (qentë dhe macet)  Përfshin materiale ku karakteristikat thelbësore nuk kanë ndryshuar, gjaku i ngrënë i kafshëve nuk merret nga peshku për konsum njerëzor

	<b>Kapitulli 15: Yndyrnat dhe vajrat shtazore dhe produktet e tyre të ndara, yndyrnat e përgatitura të ngrënshme, dyllëra shtazore ose bimore</b>	
--	---	--

1. Ky kapitull nuk përfshin:
- a) dhjain e derrave ose shpendëve të kreut 0209;
  - b) gjalpin e kakaos, yndyrë dhe vaj (kreu 1804);
  - c) përgatitjet e ngrënshme që përmbajnë më shumë se 15 % të peshës, produkte të kreut 0405 (në përgjithësi kapitulli 21);
  - d) greaves (mbetje të dhjait të shkrirë (kreu 2301) apo mbetjet e krerëve 2304 deri në 2306;
1. Kreu 1518 nuk përfshin yndyrnat ose vajrat ose fraksionet e tyre, thjesht të çnatyruara, të cilat janë klasifikuar në kreun e përshtatshëm që i korrespondon yndyrnave dhe vajrave të çnatyruara dhe fraksionet e tyre.
2. Materiale sapuni, llum dhe mbetje të vajrave dhe dhjamërave, katran i stearinës, katran i glicerinës dhe mbetje të yndyrnave të leshit që futen në kreun 1522.

		<p>Të gjitha derivatet e vajrave shtazore</p> <p>Kriteret e përzgjedhjes shtesë në përputhje me legjislacionin në fuqi për: Yndyrnat dhe vajrat e peshkut Yndyrnat e përfutuara nga kategoria 2: materiale për qëllime oleo-kimike Derivatet e yndyrës Derivatet e yndyrës që përfshijnë produktet në fazën e parë që vijnë nga yndyrnat dhe vajrat kur janë në gjendje të pastër të prodhuara me një metodë të përcaktuar në legjislacion Derivatet e përziera me materiale të tjera nuk përfshihen</p>
1501 00	Dhjamë derri (përfshirë sallon) dhe dhjamë shpendësh ndryshe nga ai i kreut 0209 apo 1503	Të gjitha
1502 00	Dhjami i gjedhëve, deleve apo dhive, ndryshe nga ato të kreut 1503	Të gjitha
1503 00	Stearina e sallos së derrit, vaj salloje, oleo-stearine, oleo-margarinë, vaj dhe dhjamë, jo në formë emulsive ose të përziera ose të përgatitur ndryshe	Të gjitha
1504	Vajra dhe dhjamëra dhe fraksionet e tyre, të peshkut apo gjitarëve detarë, nëse janë apo jo të rafinuara, por jo të modifikuara kimikisht	Vajra peshku - dhe vajra nga gjitarët e detit  Përgatitjet e ndryshme të ngrënshme janë të mbuluara nga kapitulli 21
1506 00 00	Dhjamërat dhe vajrat e tjera shtazore dhe fraksionet e tyre, nëse janë apo jo të rafinuar, por jo të modifikuara kimikisht	Yndyra dhe vajra të pandara, gjithashtu dhe fraksionet e tyre fillestare  Derivatet e përziera me materiale të tjera, nuk janë përfshirë



Kreu 1516 mbulon yndyrnat dhe vajrat me origjinë shtazore dhe bimore, të cilat kanë pësuar një transformim të veçantë kimik të një lloji të përmendur më poshtë, por që nuk kanë qenë të përgatitura edhe më tej.

Ky kre, gjithashtu, përfshin trajtimin në mënyrë të ngjashme të fraksioneve të yndyrnave dhe vajrave me origjinë shtazore dhe bimore.

15 16 10	Yndyrna dhe vajrat me origjinë shtazore dhe bimore dhe fraksionet e tyre, pjesërisht ose tërësisht hidrogjenatet, inter të esterifikuara, të riesterifikuara nëse janë të rafinuara apo jo, por i përgatitur më tej	Vetëm yndyrna dhe vajra me origjinë shtazore. Derivatet e përziera me materiale të tjera, nuk janë të përfshira në kontrollet veterinarë  Për qëllime veterinarë derivatet e yndyrnave përfshijnë produktet në fazën e parë që rrjedhin nga yndyrna dhe vajra shtazore
Ex 15 18 00	Yndyrna dhe vajra me origjinë shtazore dhe bimore dhe fraksionet e tyre, të ziera, të oksiduara, të dehidratuara, të sulfitizuara, të polimerizuara me nxehtësi në vakuum ose në gaz inert apo ndryshe të modifikuara kimikisht, duke përfshirë ato të kreut 1516; përzierjet apo përgatitjet e pangrënshme të kafshëve ose yndyrnat apo vajrat bimore ose shtazore ose të fraksioneve të yndyrnave apo vajrave të ndryshme të këtij kapitulli, që nuk janë të specifikuar ose përfshira diku tjetër	Vetëm yndyrna dhe vajra me origjinë shtazore  Vetëm yndyrna në formën e dhjavit  Derivatet e yndyrnave  Derivatet e përziera me materiale të tjera që nuk janë të përfshira
15 18 00 (91)	Yndyrna dhe vajra me origjinë shtazore dhe bimore dhe fraksionet e tyre, të ziera, të oksiduara, të dehidratuara, të sulfitizuara, të polimerizuara nga nxehtësia në vakuum ose në gaz inert apo ndryshe të modifikuara kimikisht, duke përfshirë ato të kreut 1516	Vetëm yndyrna dhe vajra me origjinë shtazore  Yndyrna në formën e dhjavit të kategorisë 2 të materialeve për qëllime oleo-kimike
15 18 00 (95)	Përzierjet apo përgatitjet e pangrënshme të yndyrnave dhe vajrave me origjinë shtazore dhe bimore dhe fraksionet e tyre	Përgatitja e yndyrnave dhe e vajrave që rrjedhin nga kafshët
1521 90 (91)	Dyllë blete si lëndë e parë dhe dyllërat e insekteve të tjera, të rafinuara ose jo	Dyllë blete, dylli për qëllime teknike  Produkte të bletarisë
1521 90 (99)	Të tjera	Produktet e bletës për qëllime bletarie  Produktet e bletarisë të tjera nga produktet e bletëve për bletari, duhet të parashtrihen sipas kodit 0511 99 "Të tjera"
	<b>Kapitulli 16: Përgatitjet prej mishit, peshkut ose krustacëve, molusqeve apo jovvertebrorëve të tjerë ujorë</b>	

1. Ky kapitull nuk përfshin mishin, të brendshmet, peshkun, krustacët, molusqet apo kafshë të tjera jovvertebrore ujore të përgatitura apo të ruajtura nga procesi i specifikuar në kapitullin 2 ose 3 ose kreun 0504.



2. Përgatitjet ushqimore përfshihen në këtë kapitull, me kusht që ato të përmbajnë më shumë se 20% të peshës së tyre sallam, mish, të brendshme, gjak, peshk apo krustacë, molusqe ose kafshë të tjera jovvertebrore ujore, apo ndonjë kombinim i tyre. Në rastet kur përgatitja përmban dy ose më shumë nga produktet e përmendura më sipër, ajo është klasifikuar në kreun e kapitullit 16, që i korrespondon përbërësit ose përbërësve, të cilët mbizotërojnë në peshë. Këto dispozita nuk zbatohen për produktet e kreut 1902 apo për përgatitjet e kreut 2103 apo 2104.

		Ky kapitull përfshin produktet e përbëra që përmbajnë produkte të përpunuara shtazore
1601 00	Sallam dhe produkte të ngjashme, të mishit, të brendshmeve ose të gjakut; Përgatitjet ushqimore duke pasur si bazë këto produkte	Përfshin mishin e ruajtur në forma të ndryshme
1602	Përgatitje të tjera të mishit ose mishit të ruajtur, të brendshmeve ose gjakut	Përfshin mishin e ruajtur në forma të ndryshme
1603 00	Ekstraktet dhe lëngjet e mishit, peshkut ose krustacëve, molusqeve apo kafshëve të tjera ujore jovvertebrore	Të gjitha: përfshin serum, proteina peshku në formë xheli të ftohtë e të ngrirë
1604	Peshk i përgatitur ose i ruajtur (konservuar); havjar dhe zëvendësuesit e havjarit të përgatitur nga vezët e peshkut, peshku i plotë ose i ndarë në pjesë, por jo i grirë	Të gjithë: Përgatitjet e gatuar apo të paragatuar të kuzhinës, që përmbajnë molusqe apo peshk  Përfshin peshkun e konservuar dhe havjarin e konservuar hermetikisht në kontejnerë  Produktet e peshkut të përziera me makarona janë të përfshira në kreun 1902
1605	Krustacët, molusqet dhe kafshë të tjera jovvertebrore ujore, të përgatitura apo të ruajtura (konservuara)	Të gjithë: Të gjithë kërmijtë e përgatitur plotësisht ose parapërgatitur janë në këtë kre  Përfshin krustacët e konservuar, apo jovvertebrorët e tjerë ujorë
	<b>Kapitulli 17: Sheqernat dhe ëmbëlsirat me sheqer</b>	
	Ky kapitull nuk përfshin sheqernat kimikisht të pastra, përveç sukrozës, laktozës, sheqerit nga mjalti, glukozës dhe fruktozës	
1702 11 00	Laktozë dhe shurup laktoze, që përmban 99 % të peshës ose më shumë laktozë, shprehur si laktozë anhidrike, të llogaritur mbi lëndën e thatë	
	<b>Kapitulli 19: Përgatitjet me drithëra, miell, niseshte ose qumësht, produkte pasticerie</b>	

Ky kapitull nuk përfshin, përveç në rastin e produkteve të mbushura të kreut 1902, përgatitjet ushqimore që përmbajnë më shumë se 20% të peshës, sallamit, mishit, të brendshmeve, gjakut, peshkut apo krustacëve, molusqeve apo kafshëve të tjera jovvertebrore ujore, apo ndonjë kombinim i tyre (kapitulli 16).



		Ky kapitull përfshin produktet e përbëra që përmbajnë produkte të përpunuara shtazore
1901	Ekstrakt malti; përgatitjet ushqimore prej miellit të grurit, bollgurit, miellit të misrit, niseshtesë ose ekstraktit të maltit, që nuk përmbajnë kakao apo që përmbajnë kakao më pak se 40% të peshës të llogaritur mbi një bazë totalisht të çyndyrosur, që nuk janë të specifikuar ose të përfshira diku tjetër; përgatitjet ushqimore të mallrave të krerëve 0401 deri 0404, që nuk përmbajnë kakao apo që përmbajnë më pak se 5 % të peshës nga të kakaos së llogaritur mbi një bazë totalisht të çyndyrosur, të paspecifikuara dhe të përfshira diku tjetër	Përgatitjet e gatuar (të kuzhinës) që janë të përfshira në kapitujt 16 dhe 21
Ex 1902	Brumërat, nëse janë ose jo të gatuar apo të mbushura (me mish ose substanca të tjera); ose  përgatitur ndryshe, të tilla si: spageti, makarona, petë, lazanjë, njoki, ravioli, kaneloni, couscous (kuskus) nëse janë apo jo të përgatitura	Përfshin përgatitjet e kuzhinës të gatuar ose të paragatuar që përmbajnë produkte shtazore
190220 (10)	Që përmbajnë më shumë se 20% të peshës peshk, krustacë, molusqe apo kafshë të tjera jovertebrore ujore	Të gjitha
190220 (30)	Që përmbajnë më shumë se 20% të peshës sallam dhe të ngjashme me to, mishit dhe të brendshme të çdo lloji, duke përfshirë yndyrnat e çdo lloji apo origjine	Të gjitha
190220 (91)	Të gatuar	Të gjitha
190220 (99)	Të tjera (të tjera makarona të mbushura të pagatuara)	Të gjitha
Ex 1905	Pasta (makarona)	Përfshin përgatitjet që përmbajnë mish
	<b>Kapitulli 20: Përgatitjet prej perimeve, frutave, arrave ose pjesë të tjera të bimëve</b>	

Ky kapitull nuk përfshin përgatitjet ushqimore që përmbajnë më shumë se 20% të peshës sallam, mish, të brendshme, gjak peshku apo krustacë, molusqe apo kafshë të tjera jovertebrore ujore ose ndonjë kombinim të tyre (kapitulli 16).

Ex 2004	Zarzavate të tjera të përgatitura ose të ruajtura ndryshe nga ato në uthull apo acid acetik, të ngrira, ndryshe nga produktet e kreut 2006	Ky kapitull përfshin produkte të përbëra që përmbajnë produkte të përpunuara shtazore  Përfshin ato përgatitje që përmbajnë mish
Ex 2005	Zarzavate të tjera të përgatitura ose të ruajtura ndryshe nga ato në uthull apo acid acetik, jo të ngrira, ndryshe nga produktet e kreut 2006	Përfshin ato përgatitje që përmbajnë mish
	<b>Kapitulli 21: Përgatitjet e përziera të ngrëshme</b>	

1. Ky kapitull nuk përfshin përgatitjet e ushqimit, të tjera produkte nga ato të përshkruara në 2103 ose 2104, që përmbajnë më shumë se 20% të peshës sallam, mish, gjak, peshk ose krustacë, molusqe apo kafshë të tjera jovertebrore ujore ose ndonjë kombinim të tyre (kapitulli 16).

2. Për qëllime të kreut 2104, termi i homogjenizuar i përbërësve ushqimorë nënkupton përbërës përfundimisht të homogjenizuar të dy ose më shumë përbërësve themelorë, si: peshk, mish, perime apo fruta, të vendosura për shitjen me pakicë si ushqim për fëmijët apo për qëllime dietike, në kontenierë të një peshe neto që nuk kalon 250 g. Për zbatimin e këtij përkufizimi, nuk janë marrë parasysh sasi të vogla përbërësish të shtuara në përzierje për qëllim ruajtje apo qëllime të tjera. Të tilla përgatitje mund të përmbajnë një sasi të vogël të pjesës së dukshme të përbërësve.

Kodi NK	Përshkrimi	Kualifikime dhe shpjegime
		Ky kapitull përfshin produktet që përmbajnë produkte të përpunuara shtazore
Ex 2103 (90 90)	Salcat dhe përgatitjet e tyre, përzierjet e erzave, mustardë pluhur dhe ushqimet e ngrënshe dhe mustarda e përgatitur  Të tjera	Përfshin përgatitjet që përmbajnë mish
Ex 2104	Supat dhe lëngjet e mishit, si dhe përgatitjet e tyre; përgatitjet ushqimore të përbëra të homogjenizuara	Përfshin përgatitjet që përmbajnë mish ose produkte me origjinë shtazore në përputhje me këtë rregullore
Ex 2105 00	Akulloret dhe të tjera të ngjashme të ngrënshe, nëse përmbajnë ose jo kakao	Përfshin të gjitha përgatitjet që përmbajnë qumësht të përpunuar në përputhje me këtë rregullore
Ex 2106	Përgatitje ushqimore të papërfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër	Përfshin të gjitha përgatitjet që përmbajnë mish ose produkte me origjinë shtazore në përputhje me këtë rregullore
Ex 2106 10	Koncentratet e proteinave dhe substancat proteinike të strukturuar	Përfshin të gjitha përbërjet që përmbajnë produkte me origjinë shtazore në përputhje me këtë rregullore
2106 90 (10)	Krem djathi	Të gjitha
2106 90 (98)	Të tjera	Përfshin të gjitha përbërjet që përmbajnë produkte me origjinë shtazore në përputhje me këtë rregullore
	<b>Kapitulli 23: Mbetjet dhe mbeturinat nga industrinë ushqimore, për përgatitjen e tagjisë për kafshë</b>	

Kreu 2309 përfshin produktet e një përdorimi të veçantë për ushqim për kafshë, të cilat nuk janë përmendur ose përfshirë diku tjetër të mara nga përpunimi i zarzavateve ose materialeve shtazore deri në atë masë që kanë humbur karakteristikat thelbësore të materialit origjinal të tjera nga mbetjet bimore, mbeturinat bimore dhe nënprodukte të përpunimit të tillë.



Kodi NK	Përshkrimi	Kualifikime dhe shpjegime
2301	Miellrat, kokrrizat dhe sferat, të mishit, peshkut apo krustacëve, molusqeve dhe kafshëve të tjera jovertebrore ujore, të papërshtatshme për konsum njerëzor	Përfshin: proteina shtazore të përpunuara jo të përdorshme për konsum njerëzor Miell mishi e kockash, miell puplash, yndyrna të thata, të gjitha jo për përdorim njerëzor
Ex 2309	Përgatitjet e një lloji që përdoren në ushqimin e kafshëve	Përfshin ushqimin për kafshë shoqërimi, ushqimet e përziera dhe të grira për qen
2309 10	Ushqime për qen ose mace, destinuar për shitjen me pakicë	Të gjitha
2309 90	Të tjera  Ky kre përfshin produkte që përmbajnë peshk ose tretësira të gjitarëve të detit, produkte të qumështit ose karbohidrate të tjera	Përfshin kulloshtër dhe qumësht të lëngshëm jo për konsum njerëzor dhe produkte që përmbajnë qumësht jo për përdorim njerëzor
2309 90 (99)	Të tjera	Përfshin produkte veze jo për përdorim njerëzor dhe produkte të tjera të përpunuara me origjinë shtazore jo për përpunim njerëzor. Produktet me qëllim për ushqim për kafshë, përfshirë ushqimet e përziera (si: këmbë, bri etj.)
	<b>Kapitulli 28: Produktet e industrive kimike ose përkatëse</b>	
Ex 2835	Fosfinatet (hipofosfitet), fosfonate (fosfite) dhe fosfate, polifosfatet, të përcaktuara kimikisht ose jo	Vetëm disa fosfate të caktuara të kalciumit janë subjekt i kontrolleve
2835 (25)	Hidrogenortofosfat kalciumi (fosfat dikalciumi)	Përzgjedhja e kërkesave për fosfatin e dikalciumit bëhen sipas legjislacionit në fuqi
2835 (26)	Fosfate të tjera të kalciumit	Përzgjedhja e kërkesave për fosfatin e trikalciumit bëhen sipas legjislacionit në fuqi
	<b>Kapitulli 30: Produktet farmaceutike</b>	
		Produktet mjekësore të përfunduara nuk mbulohen nga legjislacioni veterinar për import. Produktet e ndërmjetme që vijnë nga kategoria 3, materiale të caktuara për përdorime teknike në pajisjet mjekësore, diagnostikimet <i>in vitro</i> , reagjentët. laboratorikë dhe kozmetikë janë të përfshirë
3001	Gjëndrat dhe organet e tjera për përdorime organo-terapeutike, nëse janë ose jo të bëra pluhur, ekstraktet e gjëndrave ose organeve të tjera ose sekrecionet e tyre për përdorime organo-terapeutike, heparina dhe kripërat e saj, substancat e tjera për njerëz ose kafshë, të përgatitura për përdorime terapeutike ose profilaktike, jo të specifikuar ose përfshira	Përfshin: materiale të përfuara vetëm nga kafshët

	diku tjetër	
3001 (10)	Gjëndrat dhe organet e tjera, të thara, të bëra pluhur ose jo	Produktet vetëm me origjinë shtazore
301 (20 90)	Ekstraktet e gjëndrave ose organeve të tjera ose sekrecionet e tyre, të tjera	Produktet vetëm me origjinë shtazore
Ex 3002	Gjaku i njerëzve; gjaku i kafshëve i përgatitur për përdorime terapeutike, profilaktike ose diagnostike nëse merret nga proceset bioteknike, vaksinat, toksinat, kulturat e mikroorganizmave dhe produkte të ngjashme	Vetëm produktet me origjinë shtazore
3002 (10 10)	Antisera dhe fraksione të tjera gjaku dhe produktet imunologjike të modifikuara, të përfuara ose jo nga mënyrat e proceseve bioteknologjike	Antisera vetëm me origjinë shtazore  Përfshihet produktet mjekësore të përgatitura dhe të përfunduara për konsumatorin e fundit
3002 (10 99)	Hemoglobina, globulinat e gjakut dhe globulina serumi. Të tjera	Vetëm materialet e përfuara nga kafshët
3002 (90 30)	Gjaku i kafshëve i përgatitur për përdorime terapeutike, profilaktike ose diagnostike	
Ex 3002 (90 50 )	Kulturat e mikroorganizmave	Patogjenët dhe kulturat e patogjenëve
Ex 3002 (90 90)	Të tjera	Patogjenët dhe kulturat e patogjenëve
	<b>Kapitulli 31: Fertilizuesit</b>	
		Ky kapitull nuk mbulon gjakun e kafshëve të kreut 0511
Ex 3101 00 00	Fertilizuesit e kafshëve, nëse janë përzier ose jo bashkë; ose trajtuar kimikisht; fertilizuesit e prodhuar nga përzierja ose trajtimi kimik i produkteve shtazore ose bimore	Vetëm produktet e përfuara nga kafshët në formë të papërzier. Përfshihet plehun organik, por përzierjet pleh organik-kimik dhe fertilizuesit përfshihen
	<b>Kapitulli 35: Substancat albuminoze, niseshte të modifikuara, ngjitës, enzima</b>	
Ex 3501	Kazein, kazeinat dhe derivate të tjera kazeine; ngjitëse kafeine	Kazeina për konsum njerëzor ose për ushqyerje kafshësh  Përzgjedhja e kërkesave për qumësht, produkte me bazë qumështi dhe kulloshtës jo për konsum njerëzor bëhen sipas legjislacionit në fuqi
Ex 3502	Albuminat (përfshihet përqendrimet e dy ose më shumë proteina hirre, që përmban nga masa më shumë se 80% proteina hirre llogaritur në peshë të thatë), albuminat dhe derivatet e tjera të albuminës	Përfshihet produktet e përfuara nga vezët dhe nga qumështi destinuar për konsum njerëzor ose jo (që përfshihet të ushqyerit e kafshëve), siç specifikohet më poshtë  Produktet e vezëve dhe baxhove dhe produktet e përpunuara për konsum njerëzor janë përcaktuar në udhëzimin nr. 5, datë 25.3.2011, si dhe në udhëzimin nr. 21, datë 25.11.2010
Ex 3503 00	Xhelatina (përfshihet xhelatinën në fleta drejtkëndëshe (përfshirë katrorët) nëse janë punuar ose ngjyrosur në sipërfaqe) dhe xhelatina e prejardhur, xhelatina e peshkut, ngjitëse të tjera me origjinë shtazore, me	Xhelatinë për konsum njerëzor dhe industrinë ushqimore  Xhelatinat nën kreun 9602 janë përfshirë nga kontrollat veterinarë



	përrjashtim të ngjitësve të kazeinave të kreut 3501	
Ex 3504 00 00	Peptonet dhe derivatet e tyre; substancat e tjera proteinike dhe derivatet e tyre, që nuk specifikohen ose përfshihen diku tjetër, pluhur lëkure nëse është ose jo e ngjyrosur	Kolagjen dhe proteina të hidrolizuara  Përfshin proteina me bazë produkte kolagjeni të nxjerra nga lëkura, tejsat e kafshëve, duke përfshirë kockat në rastin e derrave, shpendëve dhe peshkut  Përfshin proteinat e hidrolizuara që përbëhen nga polipeptide, peptide ose aminoacideve dhe përzierjeve të tyre, përfutur nga hidroliza e nënprodukteve shtazore  Përfshin çdo nënprodukt qumështi për konsum njerëzor
Ex 3507	Enzimata: enzimata e përgatitura të paspecifikuara ose përfshira diku tjetër	Mullëza dhe koncentratet për konsum njerëzor
Ex 3507 10 00	Mullëza dhe koncentratet e tyre	
	<b>Kapitulli 41: Lëkurët e papërpunuara (me përrjashtim të lëkurave me qime) dhe lëkurat</b>	
		Lëkura e thundrakëve dhe shpendëve vetëm nën krerët 4101, 4102, 4103
4101	Lëkurët e papërpunuara të gjedhit (përfshirë buallin) ose kuajt (të freskëta, të thara, të gëlqeruara, në shëllirë ose të trajtuara ndryshe, por jo të regjura, të pergamenizuara ose të përgatitura më tej) nëse janë hequr apo prerë qimet	Kontrollet veterinarë aplikohen vetëm në lëkurët e freskëta, të ftohura ose të trajtuara  Përfshin lëkurët e thara, të thara të kriposura, të lagura të kriposura ose të ruajtur nga një proces tjetër nga regjia
4102	Lëkurët e papërpunuara të dhenve ose qengjave (të freskët, të kripur, të tharë, të gëlqeruar, në shëllirë ose të ruajtura ndryshe, por jo të regjura, të pergamenizuara ose të trajtuara më tej), nëse kanë lesh ose i është hequr, të tjera nga ato që përrjashtohen nga shënimi 1(c) i këtij kapitulli	Aplikohen vetëm te lëkurët e freskëta, të ftohura ose të trajtuara  Përfshin lëkurët e freskëta, të thara të kriposura, të lagura të kriposura ose të ruajtura nga një proces tjetër nga regjia
4103	Lëkurët e tjera të papërpunuara (të freskëta, të kriposura, të thara, të gëlqeruara, në shëllirë ose të ruajtura ndryshe, por jo të regjura, pergamenizuara ose të përgatitura më tej), nëse janë hequr ose prerë qimet, të tjera nga ato të përrjashtuara nga shënimi 1(b) ose 1(c) i këtij kapitulli	Përfshin vetëm lëkurët e freskëta, të ftohura ose të trajtuara  Përfshin lëkurët e zogjve ose të peshkut dhe mundësisht kafshëve të gjahut
	<b>Kapitulli 42: Artikujt e lëkurës, takëmet e kuajve dhe parzmoret, mallrat e udhëtimit, çanta dore dhe pajisje të ngjashme, të brendshme kafshësh (të tjera nga të brendshmet e krimbit të mëndafshit)</b>	

1. Ky kapitull nuk mbulon (midis produkteve të tjera) produktet që nuk kanë interes veterinar:

- a) zorrë sterile kirurgjikale ose materiale të ngjashme sterile për qepje (kreu 3006);
- b) fije, lëkurë për daulle ose pjesë të tjera të instrumenteve muzikore (kreu 9209).

4205 00 00	Artikuj të tjerë lëkure ose përbërje lëkure	Përfshin materialet për përtyypje qensh.
Ex 4206	Artikuj të zorrëve (të tjera nga zorrët e krimbit të mëndafshit)	Gjithashtu, përfshin materialet për përtyypje qensh
	<b>Kapitulli 43: Gëzofë lëkure dhe gëzofë artificiale prodhuar prej saj</b>	

1. Gjatë emërtimit të kombinuar referencat e ‘gëzofë lëkure’, të tjera nga gëzofët e lëkurës së papërpunuar të kreut 4301, aplikohet te lëkurët e të gjitha kafshëve, të cilat janë regjur ose veshur me lesh.

2. Ky kapitull nuk mbulon:

- a) lëkurët e shpendëve ose pjesët e lëkurëve të shpendëve me pupla ose push (kreu 0505 ose 6701);
- b) lëkurët e papërpunuara, me qime ose lesh të kapitullit 41 (shih vetëm 1(c) te ky kapitull).

Ex 4301	Gëzofët e lëkurës të papërpunuara (që përfshijnë kokë, bishta, putra dhe pjesë të tjera të përshtatshme për përdorim gëzofpunues), të tjera nga lëkurët e papërpunuara të kreve 4101, 4102 ose 4103	Të shpendëve ose vetëm thundrakëve
4301 (30 00)	Qengjat e mëposhtëm: astrakan, broadtail, caracul, persian dhe dele të ngjashme: indian, kinez, mongolian ose tibetian, të gjitha me ose pa koka, bishta, putra	
4301 (80 80)	Të tjera	Të shpendëve ose vetëm thundrakëve
4301 (90 00)	Koka, putra, bishta dhe pjesë të tjera ose prerje të përshtatshme për përdorim gëzofësh	
	<b>Kapitulli 51: Leshi, qime të holla ose të trasha të kafshëve, fije prej flokëve të kalit dhe pëlhurave të endura</b>	
<p>a) “lesh” kupton fije të holla të rritura të deleve ose dhive;</p> <p>b) “qime të holla kafshësh” do të thotë qime e lama, deve, jak, angora tibetan dhe kashmir ose dhi të ngjashme (por jo dhi të zakonshme), lepur (përfshirë lepujt angora) kastor ose mi uji;</p> <p>c) “qime e trashë e kafshëve” do të thotë qime kafshësh jo të përmendura më lart, duke përjashtuar furçat për larje flokësh dhe qimet e forta bërë nga flokët (kreu 0502) dhe qimet e kalit (kreu 0503).</p>		
		Për krerët 5101-5103. Përzgjedhja e kërkesave shtesë për leshin, qimet e dërrit, puplat pjesët e puplave bëhen sipas legjislacionit
5101	Leshi, i krehur ose jo	Lesh i papërpunuar
5102	Floku i kafshëve i hollë ose i trashë, të krehur ose jo	Flok i papërpunuar
Ex 5103	Mbeturinat e leshit ose qimet e imta ose të trasha, që përfshijnë fijet e papunuara	Lesh i papërpunuar



5103 (10 10)	Noilet e leshit të pakarbonizuara	Lesh i papërpunuar
	<b>Kapitulli 95: Lodrat, lojëra dhe sportet e nevojshme: pjesët dhe aksesorët e tyre</b>	
Ex 9508	Roundabouts (tërthoras, i trashë ose jo i drejtpërdrejtë), galeritë për qitje dhe panaiet zbavitëse; cirqet dhe kopshtet zoologjike lëvizëse; teatrot lëvizëse	Cirku dhe kopshti zoologjik me kafshë të gjalla
	Cirqet lëvizëse dhe kopshtet zoologjike lëvizëse	Cirku dhe kopshti zoologjik me kafshë të gjalla
	<b>Kapitulli 97: Veprat e artit, sende të koleksionuara dhe antike</b>	
EX 9705 00 00	Koleksionet dhe copë të koleksioneve me interes zoologjik, botanik, mineralogjik, anatomik, historik, arkeologjik, paleontologjik, etnografik apo interesi numizmatik	Vetëm produktet që rrjedhin nga kafshët  Përjashton trofetë e lojërave nga dythundrakë ose shpendët, që kanë pësuar një balsamim të plotë të kafshës duke siguruar ruajtjen e tyre në temperaturën e ambientit, lojërat dhe trofetë nga lloje të tjera nga/ose dythundrakë dhe shpendët (nëse janë të trajtuara ose të patrajtuara)

## SHTOJCA II

Produktet ushqimore, të cilat nuk janë objekt i kontrolleve veterinarë sipas rregullores nr. 7, datë 3.7.2000 “Për parimet e organizimit të kontrolleve veterinarë të produkteve, që hyjnë në Republikën e Shqipërisë nga vendet e treta”, në përputhje me nenin 6.1 (B) të kësaj rregulloreje, janë si më poshtë:

- Biskotat;
- Buka;
- Kekët;
- Çokollata;
- Produktet e pastiçerisë (përfshirë ëmbëlsirat);
- Kapsulat e pambushura të xhelatinës;
- Shtesa ushqimore të paketuara për konsumatorin e fundit, sasi të vogla që përmbajnë produkte shtazore, si dhe duke përfshirë glukozaminën, chondroitin ose chitosanin;
- Ekstrakte mishi dhe koncentrat mishi;
- Ullinj të mbushur me peshk;
- Makarona dhe petë që nuk janë të përziëra ose të mbushura me produkte mishi;
- Supë dhe aromatizues të paketuara për konsumatorin e fundit, që përmbajnë ekstrakte të mishit, koncentrate mishi, yndyrë shtazore ose vajra të peshkut, të pluhurosura apo ekstrakt.



**URDHËR**

**Nr. 219, datë 29.5.2012**

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA TË STUDIMIT PRANË INSTITUCIONIT  
PRIVAT “SHKOLLA E LARTË NDËRKOMBËTARE E TIRANËS”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 44/1 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 281, datë 18.3.2009 “Për licencimin e institucionit privat “Shkolla e Lartë Ndërkombëtare e Tiranës”

**URDHËROJ:**

1. Hapjen pranë institucionit privat “Shkolla e Lartë Ndërkombëtare e Tiranës”, të programit të studimit të ciklit të parë në “Infermieri e përgjithshme”, që realizohet me 180 kredite, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike, në formën e studimit me kohë të plotë dhe në përfundim të të cilit lëshohet diplomë universitare “Bachelor” në “Infermieri e përgjithshme”.

2. Hapjen pranë institucionit privat “Shkolla e Lartë Ndërkombëtare e Tiranës”, të programit të studimit të ciklit të parë në “Teknologji informacioni dhe komunikimi”, që realizohet me 180 kredite, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike, në formën e studimit me kohë të plotë dhe në përfundim të të cilit lëshohet diplomë universitare “Bachelor” në “Teknologji informacioni dhe komunikimi”.

3. Hapjen pranë institucionit privat “Shkolla e Lartë Ndërkombëtare e Tiranës”, të programit të studimit të ciklit të parë në “Mësuesi për ciklin e ulët”, që realizohet me 180 kredite, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike, në formën e studimit me kohë të plotë dhe në përfundim të të cilit lëshohet diplomë universitare “Bachelor” në “Mësuesi për ciklin e ulët”.

4. Hapjen pranë institucionit privat “Shkolla e Lartë Ndërkombëtare e Tiranës”, të programit të studimit të ciklit të parë në “Mësuesi për ciklin parashkollor”, që realizohet me 180 kredite, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike, në formën e studimit me kohë të plotë dhe në përfundim të të cilit lëshohet diplomë universitare “Bachelor” në “Mësuesi për ciklin parashkollor”.

5. Hapjen pranë institucionit privat “Shkolla e Lartë Ndërkombëtare e Tiranës”, të programit të integruar të studimit të ciklit të dytë “Master i shkencave” në “Farmaci”, që realizohet me 300 kredite, me kohëzgjatje normale 5 vite akademike, në formën e studimit me kohë të plotë dhe në përfundim të të cilit lëshohet diplomë universitare “Master i shkencave”, në “Farmaci”.

6. Këto programe studimi hapen në bazë të vendimeve nr. 168, datë 15.4.2011, nr. 293, datë 20.12.2011 dhe nr. 306, datë 16.3.2012 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë, bashkëlidhur këtij urdhri.

7. Institucioni privat “Shkolla e Lartë Ndërkombëtare e Tiranës”, duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit të këtyre programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

8. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij urdhri.

9. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, Drejtorja e Zhvillimit të Arsimit Jopublik dhe institucioni privat “Shkolla e Lartë Ndërkombëtare e Tiranës”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS**

**Myqerem Tafaj**



## URDHËR

Nr. 220, datë 29.5.2012

### **PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA “MASTER PROFESIONAL” DHE FILLIMIN E VEPRIMTARISË AKADEMIKE PËR KËTO PROGRAME, PRANË SHKOLLËS SË LARTË PRIVATE “UNIVERSITETI PLANETAR I TIRANËS”, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 911, datë 26.8.2009 “Për licencimin e shkollës së lartë private “Universiteti Planetar Tiranës””,

#### URDHËROJ:

1. Hapjen pranë Fakultetit të Shkencave të Zbatuara të Shkollës së Lartë Private “Universiteti Planetar i Tiranës”, Tiranë, dhe fillimin e veprimitarisë akademike për programet e reja të studimit të ciklit të dytë, që realizohen me 90 kredite, me kohëzgjatje normale 1.5 vite akademike, në formën e studimit me kohë të plotë dhe në përfundim të të cilave lëshohet diplomë universitare “Master profesional” në:

- a) Infermieri klinike;
- b) Infermieri pediatrie;
- c) Infermieri kirurgjikale;
- d) Infermieri geriatrike.

2. Këto programe studimi hapen në bazë të vendimit nr. 231, datë 16.9.2011 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë, bashkëlidhur këtij urdhri.

3. Shkolla e lartë private “Universiteti Planetar i Tiranës” Tiranë, duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit të këtyre programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

4. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij urdhri.

5. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Jopublik dhe shkolla e lartë private “Universiteti Planetar i Tiranës”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS

Myqerem Tafaj

## URDHËR

Nr. 230, datë 6.6.2012

### **PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË RI TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË “BACHELOR” NË “LOGOPEDI” DHE FILLIMIN E VEPRIMTARISË AKADEMIKE PËR KËTË PROGRAM PRANË SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE PRIVATE “MEDIKADENT”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 44/1 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 674, datë 27.9.2006 “Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare private “Medikadent””

**URDHËROJ:**

1. Hapjen pranë Fakultetit të Shkencave Mjekësore të Aplikuara të shkollës së lartë universitare private “Medikadent”, Tiranë, të programit të ri të studimit të ciklit të parë në “Logopedi”, që realizohet me 180 kredite, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike, në formën e studimit me kohë të plotë dhe në përfundim të të cilit lëshohet diplomë universitare “Bachelor” në “Logopedi”.

2. Ky program studimi hapet në bazë të vendimit nr. 140, datë 21.1.2011 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë, bashkëlidhur këtij urdhri.

3. Shkolla e lartë universitare private “Medikadent”, duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit të këtij programi studimi, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

4. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij urdhri.

5. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Jopublik dhe shkolla e lartë universitare private “Medikadent”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS**  
**Myqerem Tafaj**

**VENDIM**

**Nr. 67, datë 6.6.2012**

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “HYDROBORSH” SHPK NË AKTIVITETIN E  
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HECET “FTERRA”, “FTERRA 1”**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, nenit 9 dhe nenit 13 pika 1 germa “a” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1 germa “a”, neni 5 pika 1 germa “a” dhe nenit 13 dhe 14 pika 1 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.6.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “HYDROBORSH” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Hydroborsh” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.



Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

**VENDOSI:**

1. Të licencojë shoqërinë “Hydroborsh” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hecet: “Fterra” me fuqi 1.08 MW dhe “Fterra 1” me fuqi 2 MW, për një afat 30-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Sokol Ramadani**

**VENDIM**

**Nr. 68, datë 6.6.2012**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “EVN TRADING”  
SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, neneve 9 dhe 13 pikat 1 germa “d” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa “g”, neneve 8 dhe 10 pika 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, dhe nenit 18, pikat 1 germa “a” të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.6.2012, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “EVN Trading” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “EVN Trading” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar tërësisht;
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

**VENDOSI:**

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për licencë të shoqërisë “EVN Trading” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Sokol Ramadani

**VENDIM**  
**Nr. 69, datë 6.6.2012**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “DANSKE  
COMMODITIES ALBANIA” SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGISË  
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, neneve 9 dhe 13 pika 1 germa “d” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa “g”, neneve 8 dhe 10 pika 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, dhe nenit 18 pikat 1 germa “a”, të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.6.2012, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Danske Commodities Albania” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Danske Commodities Albania” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

**VENDOSI:**

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për licencë të shoqërisë “Danske Commodities Albania” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Sokol Ramadani



**VENDIM**  
**Nr. 70, datë 6.6.2012**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “E.T.H.H.” SHPK  
NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HECET “KOZEL”,  
“HELMES 1” DHE “HELMES 2”**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, nenit 9 dhe nenit 13 pika 1 germa “a” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa “a”, dhe nenit 10 pikat 3 dhe 4 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1 germa “a” të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.6.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “E.T.H.H.” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “E.T.H.H.” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar pjesërisht.

Mungesa e dokumentacionit që ka të bëjë me miratimin e pikës së lidhjes, nga shoqëria “CEZ Shpërndarje” sh.a. (pika 4.1.5 e nenit 9), është në proces miratimi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

**VENDOSI:**

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “E.T.H.H.” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hecet “Kozel”, “Helmes 1” dhe “Helmes 2”.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Sokol Ramadani**

**VENDIM**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 21006-01100-51-2011, datë 23.1.2012, vendosi transferimin e kujdestarisë nga Qendra e Zhvillimit Shkodër në Shtëpinë Rregullatorët e Bashkësisë Misionarët e Dashurisë Kontemplative për Arben Hasan Allmetën.

**VENDIM**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 21006-02637-51-2011, datë 2.2.2012, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Besnik Fatmir Kakanozi, lindur më 14.10.1975 në Tiranë dhe vendosjen e tij në kujdestarinë e Esat Xhavit Matjas.

**VENDIM**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 21006-02463-51-2011, datë 22.2.2012, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetases Suella Edi Gjondedaj, e datëlindjes 6.5.1989 dhe dhënien e kujdestarisë për këtë shtetase të “Madonina del Grappa”, Shkodër.

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 5.7.2012  
Doli nga shtypi më 6.7.2012

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2012

Çmimi 42 lekë